



## Fatura Tatimore - Trajtimi i përgjithshëm

Çdo shitblerje mallrash apo të drejtash, si dhe çdo kryerje punimi apo shërbimi, që është pjesë e veprimtarisë tregtare, është objekt faturimi.

Faturat për shitjen e sendeve apo kryerjen e punimeve e të shërbimeve janë fatura tatimore, të cilat përfshihen në përlogaritjet e detyrimit tatimor.

### Çfarë përmban

Fatura tatimore përmban numrin rendor dhe numrin personal të identifikimit, numrin e identifikimit të tatimpaguesit, datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe adresën e palëve, datën e realizimit të shitjes ose të punimit apo shërbimit, emërtimin e saktë të tyre, çmimin e plotë të shitjes dhe, nëse është rasti, rritjet ose zbritjet e tjera, të zbatuara, si dhe shumat e shifruara, cilado qoftë mënyra e likuidimit të faturës.

Faturë tatimore konsiderohet **fatura me Tatim mbi Vlerën e Shtuar**, e cila lëshohet nga personat e tatueshëm, subjekte të TVSH-së apo subjekte të Tatimit mbi Fitimin, si dhe **Fatura e Thjeshtë Tatimore**, e cila lëshohet nga persona të tatueshëm, subjekte të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin e biznesit të vogël kur nuk janë subjekte të TVSH-së, si dhe nga organizatat jofitimprurëse, fondacionet, institucionet buxhetore etj..

### Si mbahet

Fatura tatimore, përgatitet në jo më pak se dy kopje. Kur furnizuesi i mallrave apo shërbimeve e gjykon të nevojshme ose kur dispozitat e legjislacionit tatimor e kërkojnë një gjë të tillë, fatura lëshohet në më shumë se dy kopje. Kopjen origjinale të faturës tatimore të shitjes e merr dhe e ruan kurdoherë blerësi, pasi vetëm kopja origjinale i jep të drejtë atij për të kredituar TVSH-në (kur është rasti), si dhe për të justifikuar shpenzimet e zbritshme të biznesit për efekt të Tatimit mbi Fitimin apo të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin, të biznesit të vogël.

### Kur humbet kopja origjinale

Në rastin e humbjes së kopjes origjinale të faturës së blerjes, për efekt të njohjes së shpenzimeve të zbritshme të biznesit, mund të shërbejë edhe kopja e noterizuar e faturës, me kushtin që ajo, nga verifikimi të rezultojë e deklaruar nga shitësi.

## Raste të tjera

Në rastin e shitjes së dekoderave, në faturën tatimore, shkruhet numri personal i identifikimit të individit blerës të dekoderit. Numri personal i identifikimit të blerësit, person i patatueshëm, vendoset në vendin e përcaktuar në faturë, për vendosjen e NUIS/NIPT-it, për rastet kur blerës është një person i tatueshëm.